REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË**
**REKTORATI**

Nr 964/3 Prot. Vlorë më, 06.07.2022

**VENDIM**

**Nr. 11, DATË 30. 06. 2022**

**PËR**
**MIRATIMIN E FINANCIMIT NGA UV PËR VITIN BUXHETOR 2022 TË PROJEKTEVE FITUESE TË FAKULTETIT TË SHËNDETIT**

Në zbatim të Nenit 40 të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 82, pika 2, gërma c, të Statutit të UV-së neni 82, pika 2, gërma c,si dhe referuar shkresës së Dekanit të Fakultetit të Shëndetit më nr. 111/2 prot, datë 22.06.2022, Rektorati në mbledhjen e zhvilluar në datën 30.06.2022,

**VENDOSI**

1. Të miratojë financimin nga UV për vitin buxhetor 2022 të projekteve fituese të Fakultetit të Shëndetit. (sipas materialit bashkëlidhur).
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Zv. Rektori për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillim Institucional, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në UV.
3. Ky vendim i bëhet me dije Fakultetit të Shëndetit në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**REKTORI**

**Prof. Dr. Roland ZISI**

Adresa /Adress: L. Pavarsia, Bulevardi Vlorë-Skelë
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORË
ZYRA E PROTOKOLL - ARKIVËS
NR. 898/1 PROT.
DATA 24. 06 2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË**
**FAKULTETI I SHËNDETIT**
**DEKANIA**

Nr. 111/2 prot.

Vlorë, më 22 . 06 .2022

Lënda: Projektet fituese të Fakultetit të Shëndetit, të financuara nga UV për vitin buxhetor 2022.

UNIVERSITETIT 'ISMAIL QEMALI', VLORË

**Rektorit të Universitetit**
Prof.Dr. Roland Zisi

Në mbështetje të vendimit të Senatit Nr.16, datë 06.05.2021 për 'Miratimin e Procedurës së Aplikimit, Miratimit, Implementimit dhe Pagesës së Mini-Projekteve të financuara nga buxheti i UV-së', Komisioni i Vlerësimit Përfundimtar të Projekteve të Fakultetit të Shëndetit, pasi shqyrtoi projekt-propozimet e ardhura nga strukturat kërkimore-shkencore të fakultetit, sipas Vendimit Nr.10, dt.09-06-2022 të Dekanatit, miratoi përfundimisht projektet e mëposhtme:

| Titulli i projektit | Struktura propozuese | Drejtuesi i projektit | Fondi i kërkuar nga UV |
|---|---|---|---|
| e-Shëndeti dhe vlerësimi i njohurive të studenteve dhe stafit akademik. | Qendra kërkimore-shkencore për Shëndetin Publik | Dr. Fatjona Kamberi | 100,000 L |
| Çrregullimet e gjumit, identifikimi i faktorëve që ndikojnë në çrregullim dhe mënyrat e parandalimit. | Qendra kërkimore-shkencore për Shëndetin Publik | Dr. Glodiana Sinanaj | 100,000 L |
| Barazia gjinore si mekanizëm për përmirësimin e shëndetit | Qendra kërkimore-shkencore për Politika Shëndetësore | Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli | 150,000 L |

Adresa /Adress: Blv.Ismail Qemali, Pallatet Conad, kati II, Vlorë, Albania, 9400
Tel. Fax ++35533224952
web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEKANIA

| | | | |
|---|---|---|---|
| Efektet anësore të vaksinës COVID-19 në popullatën e vaksinuar të qarkut Vlorë; evidentimi efikasitetit dhe sigurisë së vaksinave të aplikuara. | Qendra kërkimore-shkencore e Infermieristikës | Dr. Majlinda Zahaj | 150,000 L |
| Total | Fakulteti i Shëndetit | | 500,000 L |

Ky vendim i përcillet për informim Rektorit të UV.

Bashkangjitur gjenden:

1. Vendimi Nr.08, dt.16-05-2022 i Dekanatit për "Shpërndarjen e fondit të kërkimit shkencor 2022 dhe Hapjen e thirrjes për aplikime".
2. Projekt-propozimet e Qendrave kërkimore-shkencore të FSH (sipas Formateve nr.31,2 të Vendimit nr.16, dt.06-05-2021 të SA).
3. Vendimi Nr.10, dt.09-06-2022 i Dekanit për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit Përfundimtar të Projekteve të Fakultetit të Shëndetit.
4. Vendimin e Komisionit të Vlerësimit Përfundimtar të Projekteve të Fakultetit të Shëndetit për projektet fituese në Thirrjen e vitit 2022 (sipas Formatit nr.3 të Vendimit nr.16, dt.06-05-2021 të SA).

**DEKANIA E FAKULTETIT TË SHËNDETIT**

**Prof.asoc.Aurela Saliaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEKANIA

Nr. 1?1 prot.

Vlorë, më 09 . 06 .2022

**VENDIM**
**Nr.10 datë 09-06-2022**

**PËR**
**NGRITJEN E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT PËRFUNDIMTAR TË MINI-PROJEKTEVE TË FAKULTETIT TË SHËNDETIT, TË FINANCUARA NGA BUXHETI I UV-SË**

Në zbatim të Vendimit Nr.16, datë 06.05.2021 për "Miratimin e procedurës së aplikimit, miratimit, implementimit dhe pagesës së mini-projekteve të financuara nga buxheti i UV-së" pika 2. "Miratimi i projektit" për caktimin e një komisioni të përbërë nga tre (3) ekspertë (dy brenda Njësisë Kryesore dhe një të Jashtëm për vlerësimin përfundimtar të projekteve të miratuara nga Njësia Bazë

**VENDOSA:**

1. Për vlerësimin përfundimtar të projekteve të brendshme të Fakultetit të Shëndetit të ngrihet Komisioni prej tre (3) anëtarësh:
    1) Dr. Rezarta Lalo – Zv.Dekane e Kërkimit Shkencor të FSH - *kryetare*
    2) Prof.assoc. Aurela Saliaj – Dekane e Fakultetit të Shëndetit - *anëtare*
    3) Dr. Diana Çuberi – Mjeke pranë Poliklinikës Qëndrore, Vlorë - *anëtare*
2. Komisioni të realizojë vlerësimin e projekt-propozimeve të njësive bazë të Fakultetit të Shëndetit sipas formularëve të miratuara në Vendimin e mësipërm të SA brenda datës 24-06-2022.

**DEKANIA E FAKULTETIT TË SHËNDETIT**

**Prof.asoc.Aurela Saliaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË**
**FAKULTETI I SHËNDETIT**
**DEKANIA**

Nr. 106 prot. Vlorë, më 31.05.2022

**VENDIM**

**I DEKANATIT TË FAKULTETIT TË SHËNDETIT**
**Nr.08, datë 16-05-2022**
**për**
**"SHPËRNDARJEN E FONDIT TË KËRKIMIT SHKENCOR 2022 dhe HAPJEN E THIRRJES PËR APLIKIME"**

Dekanati i Fakultetit të Shëndetit, i mbledhur sot më datë 16.05.2022, bazuar në Vendimin nr 8, datë 11.03.2022 për " Miratimin e Buxhetit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë për vitin 2022, pasi diskutoi për Shpërndarjen e Fondit Kërkimor Shkencor

**VENDOSI:**

1. Fondi i kërkimit shkencor për vitin 2022 prej 500 000 lekësh të shpërndahet midis: Qendrës Kërkimore Shkencore të Shëndetit Publik dhe dy grupeve Kërkimore-Shkencore të njësive bazë, në funksion të fuqizimit të punës kërkimore të të gjitha njësive përkatëse.

2. Shpërndarja e fondit do të bëhet si më poshtë:
   - Qendra Kërkimore Shkencore e Shëndetit Publik – 200,000 L
   - Grupi Kërkimor Shkencor i Infermierisë – 150,000 L
   - Grupi Kërkimor Shkencor i Politikave Shëndetësore – 150,000 L

3. Thirrja për aplikim për mini-projekte për Fakultetin e Shëndetit 2022 hapet në datë 16-05-2022, me deadline datën 16-06-2022.
   Fushat e aplikimit janë:
   - Shëndeti Publik
   - Kujdesi infermieror
   - Kujdesi mjekësor
   - Politikat shëndetësore

Ky vendim u përcillet drejtueseve të njësive bazë.

**DEKANIA E FAKULTETIT TË SHËNDETIT**

**Prof.asoc. Aurela Saliaj**

Adresa /Adress: Blv.Ismail Qemali, Pallatet Conad, kati II, Vlorë, Albania, 9400
Tel. Fax ++35533224952
web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

Nr. ........... Prot.                                                                 Vlorë, më 15 / 06 /2022

**Lënda:** Kërkesë për të Aplikuar për Mini-Projekte të financuara nga UV

**DREJTUESES SË QENDRËS KËRKIMORE-SHKENCORE PËR POLITIKA SHËNDETËSORE**

Prof.asoc. Aurela Saliaj

**KËRKESË PËR TË APLIKUAR PËR PROJEKT**

E nderuar znj. Saliaj,

Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqiperisë", Neni 93 "Veprimtaria kërkimore-shkencore", Neni 94 "Struktura e kërkimit shkencor" dhe Neni 95: "Kërkimi Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë" pika 1; Udhëzimit Nr. 29, datë 10-09-2018, si dhe skenarit 1,2 dhe 3 të Planit Strategjik të UV, dhe

në zbatim të vendimit Nr.08, dt.16-05-2022 të Dekanatit të Fakultetit të Shëndetit për "Shpërndarjen e fondit të kërkimit shkencor 2022 dhe Hapjen e thirrjes për aplikime" Ju përcjell kërkesën për aplkimim në projektin me titull *"Barazia gjinore si mekanizëm për përmirsimin e shëndetit"*.

Ky projekt-propozim ka si qëllim kryesor vëzhgimin e situatës shëndetsore dhe diferencat gjinore në Shqipëri dhe më pas hartimi i propozimeve dhe politikave të posacme për mbylljen e këtij hendeku.

**Formati 1: Format Aplikimi i Projektit**

| INFORMACION I PËRGJITHSHËM I PROJEKT PROPOZIMIT | |
|---|---|
| Titulli i projektit | **Barazia gjinore si mekanizëm për përmirsimin e shëndetit** |
| Fusha ku aplikohet | Shëndetësi |
| Drtejtuesi i projektit | Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli |
| Grupi i punës i Projektit | DKSH |
| Qëllimi i studimit | Qëllimi i këtij projekt propozimi është vëzhgimi i situatës shëndetsore dhe diferencat gjinore në Shqipëri dhe më pas hartimi i propozimeve dhe politikave të posacme për mbylljen e këtij hendeku. |
| Objektivat kryesore | - Rishikimi i literaturës<br>- Intervista me popullata vulnerable<br>- Intervista me politikbërës<br>- Propozimi i politikave/strategjive për përmirësimin e barazisë gjinore |
| Kohëzgjatja e projektit (në muaj) | Korrik – Dhjetor 2022 |
| Partnerët të jashtëm (nëse ka) | Jo e aplikueshme |
| Buxheti total i projektit | 150,000 Lekë |
| Kapaciteti i grupit të punës | Anëtarët e DKSH kanë një eksperiencë të madhe në hartimin dhe implementimin e projekteve kërkimore shkencore. Ata kanë marrë pjesë në kërkime shkencore të aplikuara në fushën e shëndetësisë si dhe kanë publikime të shumta në revista shkencore me faktor impakti si dhe kanë marrë pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. |
| Eksperienca të mëparshmetë grupit të punës | Drejtuesi i projektit ka marrë pjesë në projekte të tjera Horizon (psh EuresPlus) si dhe projekte të 3rd Health programme (EUR-HUMAN) si dhe Erasmus+ Capacity Building. |

**Të dhënat e Drejtuesit të Projektit**

| | |
|---|---|
| Emër, mbiemër | Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli |
| Institucioni | Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali" |
| Posti që mban | Zv. Rektor |
| Grada shkencore | PhD |
| Adresa postare | Rruga Kosova, Vlorë, Kodi postar 9401 |
| Adresa e e-mail | mechili@univlora.edu.al |

1. Identifikimi i problemit dhe rëndësia e zgjidhjes (deri në 500 fjalë)

Barazia gjinore është një e drejtë njerëzore e cila theksohet edhe tek Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (OZHQ). Objektivinumër pesë (5) KA si qëllim barainë gjinore dhe është e lidhur me objektivin numër tre (3) e cila ka si qëllim Shëndet të mirë dhe mirëqënie. Literatura tregon se ka diferenca të mdha midis vdekshmërisë dhe sëmuendshmërisë në bazë të gjinisë.

2. Lidhja e projekt-propozimit me prioritetet kombëtare strategjike dhe planin strategjik të UV (deri në 300 fjalë)

Universiteti i Vlorës, duke ndjekur parimet dhe standardet ndërkombëtare, komunitare dhe të brendshme, duhet te angazhohet për promovimin e barazisë së mundësive midis grave dhe burrave. Ligji Shqiptar për Barazinë Gjinore bazohet në LIGJ Nr.9970, datë 24.7.2008 PËR BARAZINË GJINORE NË SHOQËRI. Ky projekt propozim bazohet po ashtu edhe tek Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021 – 2030, miratuar me VKM Nr. 400, date 30.06.2021, nga konventa "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas", si dhe nga të gjitha aktet e tjera ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Së fundmi, ky projekt propozim lidhet po ashtu edhe me vendimin e Senatit Akademik të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë Nr. 7, Nr/ 268/1 datë 21.02.2022 Per mirarimin e strategjise mbi barazine gjinore, UV.

3. Qëllimi i projektit (deri në 100 fjalë)

Qëllimi i këtij projekt propozimi është vëzhgimi i situatës shëndetsore dhe diferencat gjinore në Shqipëri dhe më pas hartimi i propozimeve dhe politikave të posacme për mbylljen e këtij hendeku. Ky projekt propozim do të ket një fokus specifik në popullatat vulnerable.

4. Objektivat specifike të projektit (deri në 500 fjalë)

- Rishikimi i literaturës
- Intervista me popullata vulnerable
- Intervista me politikbërës
- Propozimi i politikave/strategjive për përmirësimin e barazisë gjinore

5. Aktivitetet e projektit (deri në 1000 fjalë)

Fillimisht do të bëhet një rshikimi i literaturës në databaze kryesore. Intervista do të zhvillohen me popullata vulnerable si dhe politikbërës në këtë fushë. Rezultati final i këtij projekti është propozimi i politikave/strategjive për përmirësimin e barazisë gjinore.

6. Metodologjia për realizimin e objektivave të projektit (deri në 1000 fjalë)

Ky propozim do të bazohet në dëshmi të mbështetura në evidenca me qëllim përmirsimin e shëndetit duke uur pabarazitë gjinore të cilat kanë të bëjnë më shëndetin. Për hartimin e këtij projekti një qasje e trefishtë do të përdoret. Fillimisht do të bëhet një rishikim i literaturës (desk research) me qëllim identifikimin e problemit, politikat e ndjekura në shtetet e ndryshme etj. Më pasë intervista me popullatat vulneable do të mbahen. Së fundmi intervista me politikbërës e stakeholders do të bëhen me qëllim njohjen e situatës aktuale. Si rezultat përfundimtar dhe në bazë të informacionit të mbledhur do të hartohen politika specifike të fokusuara si në nivel lokal ashtu dhe në nivel kombëtar.

7. Rezultatet e pritshme të projektit (deri në 300 fjalë)

Pritet që të njihet dhe prezantohet saktë situata aktuale dhe në bazë të rezultateve të gjetura të hartohen politika shëndetsoe specifike të cilat do kenë në fokus jo vetëm politikbërsit por edhe profesionistët e shëndetit.

8. Përfitimiet e Universitetit nga aplikimi në këtë projekt (deri në 300 fjalë)

Universiteti do të lozi një rol kryesor si një aktor i rëndësishëm në hartimin dhe implementimin e politikave të barazisë gjinore. Ky projekt do i japi mundësinë UV që të implementojë dhe një nga pikat kryesore të politikave të kërkimit shkencor të thirrjes Horizon-Europe. Ky projekt lidhet me linjën e parë të planit strategjik të UV-së. Implementimi i projektit fokusohet në përmirësimin e shëndetit afatgjat në komunitet që është një nga pikat kryesore të planit strategjik.

9. Qëndrushmëria e rezultateve(deri në 500 fjalë)

Hartimi i politkave shëndetësore me qëllim përmirësimin e barazisë gjinore dhe implementimi i këtyre politikave do të ndihmojë në qëndrueshmërinë afatgjatë të këtij projekt propozimi.

10. Personeli që do të përfshihet në projekt

| Grada shkencore | Emër mbiemër | Detyrat në projekt |
|---|---|---|
| Prof.asoc. | Enkelejd Mëhilli | • Koordinimi i cdo pakete pune<br>• Pjesmarrje në takime bilaterale<br>• Mbledhja e të dhënave<br>• Prezantim i rezultateve në 1 takim kombëtar<br>• Hartimi i politikave |
| PhD (c) | Emirjona Kicaj | • Pjesmarrje në takime bilaterale<br>• Mbledhja e të dhënave<br>• Shkrim raporti<br>• Hartimi i politikave |
| PhD | Rezarta Lalo | • Pjesmarrje në takime bilaterale<br>• Mbledhja e të dhënave<br>• Shkrim raporti<br>• Hartimi i politikave |
| PhD | Juliana Xhindoli | • Pjesmarrje në takime bilaterale<br>• Mbledhja e të dhënave<br>• Shkrim raporti<br>• Hartimi i politikave |
| PhD (c) | Rudina Çerçizaj | • Pjesmarrje në takime bilaterale<br>• Mbledhja e të dhënave<br>• Shkrim raporti<br>• Hartimi i politikave |
| MSc | Erlini Kokalla | • Pjesmarrje në takime bilaterale<br>• Mbledhja e të dhënave |
| MSc | Stiliana Brokaj | • Pjesmarrje në takime bilaterale<br>• Mbledhja e të dhënave |
| MSc | Saimira Durmishi | • Rishikimi i literaturës<br>• Printimi dhe shpërndarja e rezultateve finale |
| Master Profesional | Desiana Kamberaj | • Pjesmarrje në takime bilaterale<br>• Mbledhja e të dhënave |
| Master Profesional | Erald Çupa | • Pjesmarrje në takime bilaterale<br>• Mbledhja e të dhënave |
| Master Profesional | Margarita Azizi | • Pjesmarrje në takime bilaterale |

| | | |
|---|---|---|
| | | • Mbledhja e të dhënave |
| | Florida Ymeraj | • Organizimi i takimeve (p.sh vendodhja, agenda etj.) |
| | Elsa Begaj | • Organizimi i takimeve (p.sh vendodhja, agenda etj.) |
| | Ismail Bitraj | • I.T mbështetje |

11. Plani i punës

| Aktiviteti/Muaji | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Rishikimi i literaturës | X | X | | | | |
| Intervista me popullata vulnerable | | | X | | | |
| Intervista me politikbërës | | | | X | | |
| Propozimi i politikave/strategjive për përmirësimin e barazisë gjinore | | | | | X | |
| Diseminim i rezultateve | | | | X | X | X |

12. Plani i punës sipas objektivave specifike

| Objektivi | Aktiviteti | Rezultati | Periudha kohore | Personi pergjegjes |
|---|---|---|---|---|
| Rishikimi i literaturës | Do të kontrollohen database ndërkombëtare me qëllim përshkrimin e situatës në Shqipëri dhe jashtë | Pritet të shikohet situata aktuale, problemet si dhe mundësitë për kapërcimin e tyre. | Korrik – Gusht | Enkelejd Mehilli<br>Stiliana Brokaj |
| Intervista me popullata vulnerable | Intervista me persona vulnerable me qëllim nevojat, dëshirat dhe preferencat e tyre. | Pritet njohja aktuale e situatës sipas eksperiencave të këtyre personave. | Shtator | Enkelejd Mehilli<br>Aurla Saliaj<br>Emirjona Kicaj |
| Intervista me politikbërës | Intervista me personel shëndetësor me | Pritet njohja aktuale e situatës sipas | Tetor | Enkelejd Mehilli<br>Aurla Saliaj<br>Stiliana Brokaj |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | qëllim shikimin e prespektivave nga ana e tyre në ofrimin e shërbimeve të barabarta pa dallime gjinore. | eksperiencave tëpersonelit shëndetësor | | Emirjona Kicaj |
| Propozimi i politikave/strategjive për përmirësimin e barazisë gjinore | Hartimi i politikave mbi barazinë gjinore. | Pritet të hartohet një strategji specifike me qëllim ofrimin e shërbimeve shëndetësore pa dallime. | Nëntor – Dhjetor | Enkelejd Mehilli<br>Aurla Saliaj<br>Stiliana Brokaj<br>Emirjona Kicaj |

Gjatë dhe pas përfundimit të projektit në emër të grupit të punës marr përsipër ti siguroj Njësisë Bazë/Njësisë Kryesore të gjithë dokumentacionin e projektit si dhe një kopje të plotë të raportit përfundimtar të projektit.

Faleminderit për bashkëpunimin,

**Në emër të grupit të punës**
Assoc. Prof. Enkelejd Mëhilli

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË

**Formati 2: Formati i propozimit financiar**

1. Titulli i projektit: *"Barazia gjinore si mekanizëm për përmirsimin e shëndetit"*
2. Drejtuesi i projektit: *Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli*

| Zëri në buxhet | Tipi | Sasia | Njësia | Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë | Përshkrimi i detajuar |
|---|---|---|---|---|---|
| Pagat e personelit (e detajuar për drejtuesin dhe stafin) | Ditë pune | 36 | Ditë pune | 150 | |
| Enkelejd Mëhilli *Drejtuesi i projektit* | | | | 28 | • Koordinimi i cdo paketë pune • Pjesmarrje në takime bilaterale • Mbledhja e të dhënave • Pjesmarrje në detyrat e cdo pakete pune • Shkrimi i rezultateve |
| Emirjona Kiçaj *Senior researcher* | | | | 20 | |
| Sajmira Durmishi *Senior researcher* | | | | 10 | |
| Rudina Çerçizaj *Senior researcher* | | | | 12 | |
| Stiliana Brokaj *Senior researcher* | | | | 10 | |
| Rezarta Lalo *Senior researcher* | | | | 10 | |
| Juliana Xhindoli *Senior researcher* | | | | 10 | |
| Erlini Kokalla *Senior researcher* | | | | 10 | |
| Margarita Aziz *Junior researcher* | | | | 0 | |
| Erald Çupa *Junior researcher* | | | | 0 | |
| Desiana Kamberaj *Junior researcher* | | | | 0 | |
| Florida Ymeraj *Sekretare* | | | | 10 | |
| Elsa Begaj *Laborante* | | | | 20 | |
| Ismail Bitraj | | | | 10 | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| *Teknik IT* | | | | | |
| Udhëtime/dieta | Copë | 0 | Copë | 0 | Lëvizje për zhvillimin e aktiviteteve |
| Seminare/konferenca | Copë | 0 | Copë | 0 | Pjesmarrje në konferencë për diseminimin e rezultateve |
| Paisje | Jo e aplikueshme | | | | |
| Aktivitete | Copë | 0 | Copë | 0 | Organizimi i takimeve me grupet e interesit |
| Publikime/botime | Copë | 0 | Copë | 0 | Printimi i rezultateve |
| Shpenzime administrative | Për/muaj | 0 | Për/muaj | 0 | |
| Të tjera (detajo) | Jo e aplikueshme | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË**
**FAKULTETI I SHËNDETIT**
**DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

**Formati 1: Format Aplikimi i Projektit**

Nr. ............. Prot.                                                          Vlorë, më 14 / 06 /2022

**Lënda:** Kërkesë për të Aplikuar për Mini-Projekte të financuara nga UV

**Këtu:**

**KËRKESË PËR TË APLIKUAR PËR PROJEKT**

E nderuar Dekane,

Prof.asoc. Aurela Saliaj

Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqiperisë", Neni 93 "Veprimtaria kërkimore-shkencore", Neni 94 "Struktura e kërkimit shkencor" dhe Neni 95: "Kërkimi Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë" pika 1; Udhëzimit Nr. 29, datë 10-09-2018, si dhe skenarit 1, 2 dhe 3 të Planit Strategjik të UV, Ju përcjell kërkesën për aplkimim në projektin me titull "Efektet anësore të vaksinës COVID-19 në popullatën e vaksinuar të qarkut Vlorë; evidentimi efikasitetit dhe sigurisë së vaksinave të aplikuara"
Ky projekt-propozim ka si qëllim kryesor "Vlerësimin e efekteve anësore të vaksinave të realizuara në popullatën e Vlorës si edhe niveli i antitrupave të krijuar tek këta individë sipas llojit të vaksinës".

| INFORMACION I PËRGJITHSHËM I PROJEKT PROPOZIMIT | |
|---|---|
| Agjencia Ekzekutuese | Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë<br>në bashkëpunim me |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

| | |
|---|---|
| | Drejtorinë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Vlorë |
| Titulli i Projektit Shqip dhe English | Efektet anësore të vaksinës COVID-19 në popullatën e vaksinuar të qarkut Vlorë; evidentimi efikasitetit dhe sigurisë së vaksinave të aplikuara |
| Fusha ku aplikohet | Shëndetësia |
| Drejtues i projektit | Dr. Majlinda Zahaj |
| Grupi i punës i Projektit | PhD candidate. Vasilika Prifti<br>Dr.Evis Allushi<br>PhD candidate. Sonila Nikaj<br>Msc.Nertila Kreshpaj<br>Msc.Vjollca Zahaj<br>Student Luljeta Habilaj<br>Student Daniel Bengaj<br>Student Paola Malaj<br>Student Lediana Lazaj<br>Student Armand Hoxha<br>Student Elvis Hoxha<br>Student Shyqyri Gjonaj |
| Qëllimi i studimit | Vlerësimi i efekteve anësore të vaksinave të realizuara në popullatën e Vlorës si edhe niveli i antitrupave të krijuar tek këta individë sipas llojit të vaksinës. |
| Objektivat kryesore | 1. Evidentimi i popullatës që ka kryer procesin e vaksinimit (dozën tretë dhe është gati për dozën e katërt) dhe llojin e vaksinës.<br>2. Vlerësimi i efekteve anësore të vaksinës pas secilës dozë të administruar.<br>3. Përcaktimi i nivelit të trupave të krijuar tek këta individë, nëpërmjet analizave të kryera 5 muaj pas realizimit edhe të dozës së tretë dhe të katërt.<br>4. Evidentimi i keqinformimeve të popullatës mbi vaksinimin<br>5. Evidentimi i perceptimeve të popullatës mbi vendimin e kryerjes së dozës së tretë dhe të katërt<br>6. Bazuar në rezultatet e studimit të evidentohet se cili lloj vaksine është më i përshtatshëm për grupmosha/sëmundje kronike. |

| | |
|---|---|
| Kohëzgjatja e projektit (në muaj) | 12 muaj |
| Partnerët të jashtëm (nëse ka) | |
| Buxheti total i projektit | 150000 |
| Kapaciteti i grupit të punës | |
| Eksperienca të mëparshme të grupit të punës | Miniprojekte të mëparshme brenda departamantit:<br>2020- Duhanpirja tek të rinjtë, Implementimi i ndërhyrjes parandaluese dhe trajnuese<br>2021 Faza e parë e projektit: Efektet anësore të vaksinës COVID-19 në popullatën e vaksinuar të qarkut Vlorë; evidentimi efikasitetit dhe sigurisë së vaksinave të aplikuara |

**2. Të dhënat e Drejtuesit të Projektit**

| | |
|---|---|
| **Emër, mbiemër** | Majlinda Zahaj |
| **Institucioni** | Fakulteti i Shëndetit, Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë |
| **Posti që mban** | Drejtuese e Departamentit të Infermierisë, Fakulteti i Shëndetit |
| **Grada shkencore** | Doktore shkencash |
| **Adresa postare** | Skelë, Rruga Kosova, 9401 |
| **Telefon fiks** | |
| **Numri i celularit** | +355 695813121 |
| **Adresa e e-mail** | majlinda.zahaj@univlora.edu.al |

**3. Argumentimi shkencor i Projektit**

3.1 Identifikimi i problemit dhe rëndësia e zgjidhjes së tij:

Bota ka mbi dy vite që po stërmundohet nën efektet e virusit SARS-COVID. Vende të ndryshme pësuan kolaps në sistemin e tyre shëndetsor për shkak të panjohurive dhe pamundësisë për trajtimin e kësaj sëmundjeje vdekjeprurëse. Krahas studimeve të ndryshme mbi mënyrat efikase të trajtimit të sëmundjes, parandalimit të transmetimit, një sërë studimesh serioze dhe frutdhënëse u fokusuan në gjetjen e vaksinave për mbrojtje të popullatës së botës. Aktualisht OBSH ka miratuar për përdorim urgjence Pfizer COVID-19 (BNT162b2) në 31 Dhjetor 2020; Moderna vetëm në SHBA; në 15 Shkurt 2021, AstraZeneca/Oxford COVID-19 dhe SKBio; në 12 Mars 2021Ad26.COV2.S, nga Janssen (Johnson & Johnson). Fillimi i imunizimit të popullatave të vendeve të ndryshme solli dhe sfida të ndryshme përsa i përket besueshmërisë së tyre për faktin e kohës relativisht të shkurtër të krijimit dhe hedhjes në përdorim, gjithashtu dhe dilemave të kryerjes ose jo. Frika mbi shfaqjen e efekteve anësore pas kryerjes së vaksinave, si dobësi, temperaturë, dhimbje koke dhe muskujsh, nausea, reaksioneve alergjike, disa vdekje nga fenomene trombotike, etj; apo dhe keqkonceptime që vaksina mund të shkaktojë vetë COVID-in, probleme të tjera shëndetësore që i atribohen vaksinës, janë disa prej keqinformimeve që pacientët kanë kudo në botë.

Në vendin tonë ka që në muajin Janar 2021, që ka filluar imunizimi i popullsisë fillimisht me vaksinën Pfizer, Astrazeneca dhe aktualisht janë duke u përdorur Sinovax (Kineze) dhe Sputnik (Ruse) të cilat akoma nuk janë miratuar nga OBSH për përdorim edhe pse shumë vende janë duke i përdorur për vaksnim masiv të popullsisë.

Sistemi ynë shëndetësor ka hasur shumë sfida lidhur me besushmërinë dhe efektivitetin e vaksinave që aktualisht popullata shqiptare po vaksinohet. Prezenca e efekteve anësore, të cilat edhe pse në disa raste akoma nuk janë ndjerë nga individët, por janë transmetuar si informacion nga një individ tek tjetri, nga media apo burime të tjera kanë patur ndikimin e tyre negativ në përjetimin aktual të këtyre efekteve.

Duke qënë se vaksinat janë në vitin e tyre të dytë të survejancës së efekteve anësore dhe të efektivitetit dhe besueshmërisë së tyre, është e rëndësishme që të kryhen sa më shumë studime.

Në Shqipëri dhe veçanërisht në qarkun e Vlorës për momentin ka fare pak studime të publikuara përsa i përket këtyre çështjeve. Studime të tilla, jo vetëm në Vlorë por në të gjithë vendin, janë të domosdoshme duke ditur që literatura mbështet të dhëna që Covid -19 nuk do të ikë shumë shpejt, por vaksinimi i popullatës mund të jetë dhe i përvitshëm. Edukimi i pacientëve mbi atë ç'ka ata të presin si efekte anësore të pranueshme, njohuritë mbi sigurinë e vaksinave në mbrojtjen e tyre duke kryer testet serologjike, inkurajimi i tyre në raportimin

e efekteve anësore dhe ndarja e popullatës sipas vaksinave që janë më të përshtatshme për ta sipas semundjes kronike, është dhe synimi i këtij projekti.

3.2 Punime të kryera deri tani ose që janë në proces në këtë fushë në institucionin tuaj ose në institucione të tjera.

- Meo SA, Bukhari IA, Akram J, Meo AS, Klonoff DC. COVID-19 vaccines: comparison of biological, pharmacological characteristics and adverse effects of Pfizer/BioNTech and Moderna Vaccines. Eur Rev Med Pharmacol Sci. 2021 Feb;25(3):1663-1669. doi: 10.26355/eurrev_202102_24877. PMID: 33629336.
- Loo KY, Letchumanan V, Ser HL, Teoh SL, Laë JË, Tan LT, Ab Mutalib NS, Chan KG, Lee LH. COVID-19: Insights into Potential Vaccines. Microorganisms. 2021 Mar 15;9(3):605. doi: 10.3390/microorganisms9030605. PMID: 33804162; PMCID: PMC8001762.
- S. Kreps et al. Factors associated ëith US adults' likelihood of accepting COVID-19 vaccination. JAMA Netë. Open 3, e2025594 (2020) Google Scholar
- Sahil Loomba, Alexandre de Figueiredo, Simon J. Piatek, Kristen de Graaf & Heidi J. Larson "Measuring the impact of COVID-19 vaccine misinformation on vaccination intent in the UK and USA"https://doi.org/10.1038/s41562-021-01056-1
- Thomas N Vilches, Kevin Zhang , Robert Van Exan , Joanne M Langley , Seyed M Moghadas "Projecting the impact of a tëo-dose COVID-19 vaccination campaign in Ontario, Canada" https://doi.org/10.1016/j.vaccine.2021.03.058
- Olivier J Ëouters, Prof Kenneth C Shadlen, Maximilian Salch, "Challenges in ensuring global access to COVID-19 vaccines: production, affordability, allocation, and deployment"
- Jim Daley "Ëhich COVID Vaccine Is 'Best'? Ëhy Do Some People Have Side Effects? By on February 19, 2021

3.3 Me cilin prioritet strategjik Sektorial lidhet projekt-propozimi juaj?

*Prioriteti strategjik sektorial 11.2:* Një sistem i kujdesit shëndetësor më i fortë dhe më i aksesueshëm

*Objektivi strategjik 1:* Përmirësimi i cilësisë së kujdesit shëndetësor, duke garantuar akses të plotë për të gjithë personat që jetojnë në Shqipëri.

*Objektivi strategjik 5:* Zhvillimi i një qasjeje të integruar dhe më të mirë koordinuar të kujdesit shëndetësor.

3.4 Kontributet specifike që sjell projekti në shkencat fondamentale dhe/ose të aplikuara

Adresa /Adress: Blv.Ismail Qemali, Pallatet Conad, kati II, Vlorë, Albania, 9400
Tel. Fax ++35533224952
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

Nëpërmjet këtij projekti do të kuptohen më mirë përjetimet e pacientëve mbi efektet anësore të vaksinave të COVID sipas dozave, duke kontribuar në kryerjen e dozës së tretë dhe të katërt dhe raportimin e efekteve anësore. Gjithashtu mënyra e kuptimit të efekteve anësore, pranimi i tyre bazuar në njohuritë mbi sëmundjen ndikon mbi individë të tjerë për kryerjen e dozave të treta e më tej nëse kanë hezitime.
Një aspekt tjetër ku do të fokusohet projekti është evidentimi i një përgjigje mbi pyetjen se cilat grupe popullatash mund të përfitojnë më shumë nga cila vaksinë duke patur parasysh sëmundjen e tyre kronike specifike, grupmoshën apo faktorë të tjerë.

## 4. Qëllimi dhe objektivat e projektit

4.1 Qëllimi

Vlerësimi i efekteve anësore të vaksinave të realizuara në popullatën e Vlorës si edhe niveli i antitrupave të krijuar tek këta individë sipas llojit të vaksinës.

Evaluation of the side effects of the vaccines applied in Vlora district population, and the evaluation of the serologic level of antibodies in this population according to the type of vaccine applied.

4.2 Objektivat e projektit (objectives)

1. Evidentimi i popullatës që ka kryer procesin e vaksinimit (dozën tretë dhe është gati për dozën e katërt) dhe llojin e vaksinës.
2. Vlerësimi i efekteve anësore të vaksinës pas secilës dozë të administruar.
3. Përcaktimi i nivelit të trupave të krijuar tek këta individë, nëpërmjet analizave të kryera 5 muaj pas realizimit edhe të dozës së tretë dhe të katërt.
4. Evidentimi i keqinformimeve të popullatës mbi vaksinimin
5. Evidentimi i perceptimeve të popullatës mbi vendimin e kryerjes së dozës së tretë dhe të katërt
6. Bazuar në rezultatet e studimit të evidentohet se cili lloj vaksine është më i përshtatshëm për grupmosha/sëmundje kronike.

## 5. Aktivitetet e projektit (të lidhura me objektivat)

1. Planifikimi i studimit: studimi i literaturës, përcaktimi i popullatës, hartimi i pyetjeve të intervistës.
2. Identifikimi i mostrës studimore dhe vendosja e kontakteve me ta nëpërmjet Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Vlorë,

3. Pyetësorë me popullatën e vaksinuar (me tre doza dhe katër doza), kontakti pas 4-5 muajsh me individët e vaksinuar për të kryer analizat laboratorike në laboratorin e FSH.
4. Përpunimi dhe interpretimi i të dhënave.
5. Shkrimi i artikujve për publikim.
6. Shkrimi i raportit teknik/shkencor dhe i raportit financiar.

## 6. Metodologjia e realizimit të projektit

6.1 Përshkrimi i detajuar i metodologjisë së kërkimit shkencor

Ky është një studim kros-seksional, i kombinuar: cilësor dhe sasior. Studimi do të kryhet në periudhën kohore Korrik 2022- Korrik 2023. Studimi do të kryhet në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Vlorë, dhe laboratorin e Fakultetit të Shëndetit.
Popullata e studimit përfshin të gjithë individët e grupmoshave të ndryshme të vaksinuar në Qarkun e Vlorës që paraqiten për vaksinimin me dozën e tretë dhe të katërt (Vlorë, Sarandë, Delvinë).

Ndryshorët që do të maten:

- Lloji i vaksinës së aplikuar.
- Efektet anësore pas dozës së tretë dhe të katërt të vaksinave të aplikuara.
- Përqindja e popullatës për vaksinim sipas dozave të rregjistruar dhe të paraqitur (kush nuk paraqitet për dozën e tretë dhe të katërt)
- Përqindja e popullatës sipas nivelit të antitrupave të krijuar.
- Niveli i perceptimit efekt anësore / vaksinë, në lidhje me efektet e vërteta anësore.
- Lidhja lloji i vaksinës/sëmundje kronike dhe/ose moshë

Instrumenti matës: Pyetësor gjysmë e strukturuar, i pregatitur nga grupi i punës.
Përpunimi statistikor: Paketa SPSS.

## 7. Rezultatet e projektit (të lidhura me objektivat dhe aktivitetet)

- Evidentimi i efekteve anësore të dozës së tretë dhe të katërt të vaksinës së aplikuar
  1. Njohja me problematikat që pacientët kanë patur pas aplikimit të secilës dozë.

2. Përcaktimi i mënyrave më efikase të informimit rreth këtyre problematikave sipas grupit të individëve të përfshirë në popullatën që po studiohet.

- Vlerësimi i hezitimit të procesit të vaksinimit sipas llojit të vaksinës të aplikuar varur nga graviteti i efekteve anësore.
  1. Krahasimi i numrit të individëve që duhet të paraqiten për administrimin e dozës së tretë dhe numrit real të individëve të paraqitur për administrim
  2. Përcaktimi i të gjithë elementeve që ndikojnë në hezitim e individëve në aplikimin e dozës së tretë dhe të katërt të vaksinës.
- Përcaktimi i kategorive të popullatës së përfshirë në studim sipas nivelit të antitrupave të krijuar.
  1. Kategorizimi i popullatës sipas antitrupave të krijuar pas procesit të vaksinimit, bazuar kjo në analizat e kryera 3-5 muaj pas realizimit edhe të dozës së tretë apo të katërt.
  2. Përcaktimi i kategorive (efekt anësor/vaksinë) në lidhje me efektet anësore. nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë me individët e përfshirë në studim.

7.1 Si mendohet t'iu bëhen të njohura rezultatet e projektit përdoruesve të mundshëm të tyre?

Në përfundim të projektit, raporti shkencor i tij do të dorëzohet edhe në FSH dhe Drejtorinë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Vlorë, me rekomandimet përkatëse për implementimin e gjetjeve të studimit.

Rezultatet e këtij projekti do të publikohen si një artikull shkencor në një revistë të indeksuar në PubMed, fee e mundshme e së cilës është parashikuar në buxhet.

## 8. Përfituesit e projektit

8.1 Përfituesit direktë

Popullata e vaksinuar

8.2 Përfituesit indirektë

Popullata e pavaksinuar, Sistemi Shëndetsor

8. Personeli që do të përfshihet në projekt:

| Grada shkencore | Emër mbiemër | Institucioni | Detyrat në projekt |
|---|---|---|---|
| Dr. | Majlinda Zahaj | Lektore, Drejtuese Departamenti Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë | Shkrimi i projekt-propozimit, planifikimi i kërkimit shkencor, pregatitja e instrumentëve matës, monitorimi i projektit, shkrimi i raportit shkencor dhe publikimeve. |
| PhD candidate | Vasilika Prifti | Asistente lektore, DI Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë | Kërkimi i literaturës, mbledhja e të dhënave kërkimore nëpërmjet intervistimit të subjekteve të studimit, rregjistrimi i të dhënave. |
| Dr. | Evis Allushi | Lektore, DI Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë | Kërkimi i literaturës, mbledhja e të dhënave kërkimore nëpërmjet intervistimit të subjekteve të studimit, rregjistrimi i të dhënave, përpunimi statistikor |
| PhD candidate | Sonila Nikaj | Asistente lektore, DI Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë | Kërkimi i literaturës, mbledhja e të dhënave kërkimore nëpërmjet intervistimit të subjekteve të studimit, rregjistrimi i të dhënave. |
| Msc. | Nertila Kreshpaj | Sekretare DI Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë | Mbajtja e dokumentacionit dhe asistenca teknike në dokumentimin e të dhënave dhe raportim. |
| MSc | Vjollca Zahaj | Laborante -DI Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë | Personi i kontaktit, mbledhja e të dhënave kërkimore nëpërmjet intervistimit të subjekteve të studimit. |
| Student | Luljeta Habilaj | Student DI Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë | Kërkimi i literaturës, mbledhja e të dhënave kërkimore nëpërmjet intervistimit të subjekteve të studimit, rregjistrimi i të dhënave. |
| Student | Daniel Bengaj | Student DI Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë | Kërkimi i literaturës, mbledhja e të dhënave kërkimore nëpërmjet intervistimit të subjekteve të studimit, rregjistrimi i të dhënave. |
| Student | Paola Malaj | Student DI Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë | Kërkimi i literaturës, mbledhja e të dhënave kërkimore nëpërmjet intervistimit të subjekteve të studimit, rregjistrimi i të dhënave. |

Adresa /Adress: Blv.Ismail Qemali, Pallatet Conad, kati II, Vlorë, Albania, 9400
Tel. Fax ++35533224952
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

| | | | |
|---|---|---|---|
| Student | Lediana Lazaj | Student DI Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë | Kërkimi i literaturës, mbledhja e të dhënave kërkimore nëpërmjet intervistimit të subjekteve të studimit, rregjistrimi i të dhënave. |
| Student | Armand Hoxha | Student DI Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë | Kërkimi i literaturës, mbledhja e të dhënave kërkimore nëpërmjet intervistimit të subjekteve të studimit, rregjistrimi i të dhënave. |
| Student | Elvis Hoxha | Student DI Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë | Kërkimi i literaturës, mbledhja e të dhënave kërkimore nëpërmjet intervistimit të subjekteve të studimit, rregjistrimi i të dhënave. |
| Student | Shyqyri Gjonaj | Student DI Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë | Kërkimi i literaturës, mbledhja e të dhënave kërkimore nëpërmjet intervistimit të subjekteve të studimit, rregjistrimi i të dhënave. |

## 9. Plani i punës

**Kalendari i aktiviteteve**

**Viti 2022-2023**

| Objektivi | Aktiviteti | Rezultati | Periudha kohore | Personi pergjegjes |
|---|---|---|---|---|
| Evidentimi i popullatës që ka kryer procesin e vaksinimit (dozën e tretë dhe të katert) dhe llojin e vaksinës.<br><br>Vlerësimi i efekteve anësore të vaksinës pas secilës dozë të administruar.<br><br>Përcaktimi i nivelit të trupave të krijuar tek | Studimi i literaturës, përcaktimi i popullatës, hartimi i pyetjeve të pyetsorit | Planifikimi i studimit | muaji 1-2 | Majlinda Zahaj<br>Vasilika Prifti<br>Luljeta Habilaj<br>Lediana Lazaj |
| | Identifikimi i mostrës studimore dhe vendosja e kontakteve | Përfshirja e individëvë në studim | muaji 2-3 | Evis Alushi<br>Sonila Nikaj<br>Nertila Kreshpaj<br>Vjollca Zahaj |
| | Njohja e efekteve ansëore specifike të individëve sipas llojit | Plotësimi i pyetesorëve nga | muaji 4-6 | Vasilika Prifti<br>Sonila Nikaj<br>Daniel Bengaj |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| këta individë, nëpërmjet analizave të kryera 5 muaj pas realizimit edhe të dozës së tretë dhe të katert.<br><br>Evidentimi i keqinformimeve të popullatës mbi vaksinimin<br><br>Lidhja midis semundjeve kronike /moshes apo faktoreve te tjere dhe llojit me te pershtatshem te vaksines | të vaksinës së administruar | individët e vaksinuar | | Vjollca Zahaj<br>Shyqyri Gjonaj |
| | Matja e nivelit të antitrupave sipas llojit të vaksinave të administruar | Efikasiteti dhe siguria e llojeve të vaksinave që jane administruar | Muaji 4-6 | Evis Alushi<br>Nertila Kreshpaj<br>Vjollca Zahaj |
| | Përpunimi dhe interpretimi i të dhënave. | | Muaji 7-8 | Sonila Nikaj<br>Luljeta Habilaj<br>Armand Hoxha |
| | Shkrimi i artikujve për publikim. | Botim artikulli | muaji 9-10 | Majlinda Zahaj<br>Evis Allushi<br>Paola Malaj |
| | Shkrimi i artikujve për publikim. | Botim artikulli | muaji 10-12 | Majlinda Zahaj<br>Evis Allushi<br>Paola Malaj<br>Elvis Hoxha |
| | Shkrimi i raportit teknik/shkencor dhe i raportit financiar. | Dorëzimi I raportit shkencor | muaji 10-12 | Majlinda Zahaj<br>Evis Allushi |

**Viti 2022-2023**

| Aktiviteti/Muaji | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Planifikimi i studimit | X | X | | | | | | | | | | |
| Përcaktimi i stafit vaksinator dhe popullatës që do të përfshihet në studim dhe vendosja e kontakteve me ta. | | X | X | | | | | | | | | |
| Plotësimi i pyetësorëve | | | X | X | X | X | | | | | | |
| Përpunimi dhe interpretimi i të dhënave të mbledhura. | | | | | | | X | X | X | | | |
| Publikimi i rezultateve: botim artikulli. | | | | | | | | | X | X | X | |
| Shkrimi i Raportit teknik të projektit. | | | | | | | | | | | X | X |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Gjatë dhe pas përfundimit të projektit në emër të grupit të punës marr përsipër ti siguroj Departamentit të Infermierisë dhe Dekanatit të Shëndetit të gjithë dokumentacionin dhe produktet e projektit si dhe një kopje të plotë të raportit përfundimtar të projektit.

Faleminderit për bashkëpunimin,

Në emër të grupit të punës

**Dr.Majlinda Zahaj**

Adresa /Adress: Blv.Ismail Qemali, Pallatet Conad, kati II, Vlorë, Albania, 9400
Tel. Fax ++35533224952
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

**Formati 2: Formati i propozimit financiar**

1. Titulli i projektit;

   Efektet anësore të vaksinës COVID-19 në popullatën e vaksinuar të qarkut Vlorë; evidentimi efikasitetit dhe sigurisë së vaksinave të aplikuara

2. Drejtuesi i projektit;
   Dr.Majlinda Zahaj

| Zëri në buxhet | Tipi | Sasia | Njësia | Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë | Përshkrimi i detajuar |
|---|---|---|---|---|---|
| Pagat e personelit (e detajuar për drejtuesin dhe stafin) | | | | | |
| Drejtuesi i projektit - Majlinda Zahaj | | | Ditë pune | - | *Funksioni:* Drejtuese projekti *Detyrat:* Shkrimi i projekt-propozimit, planifikimi i kërkimit shkencor, pregatitja e instrumentëve matës, monitorimi i projektit, shkrimi i raportit shkencor dhe publikimeve. |
| Staf teknik -Vasilika Prifti | | | Ditë pune | 80.000 | *Funksioni:* Kërkuese shkencore *Detyrat:*Kërkimi i literaturës, mbledhja e të dhënave kërkimore nëpërmjet intervistimit të subjekteve të studimit, rregjistrimi i të dhënave. |
| Staf teknik -Evis Allushi | | | Ditë pune | - | *Funksioni:* Kërkuese shkencore *Detyrat* :Kërkimi i literaturës, mbledhja e të dhënave kërkimore nëpërmjet intervistimit |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | të subjekteve të studimit, rregjistrimi i të dhënave. përpunimi statistikor |
| Staf teknik Semila Nikaj | | | Ditë pune | - | *Funksioni:* Kërkuese shkencore *Detyrat* : Kërkimi i literaturës, mbledhja e të dhënave kërkimore nëpërmjet intervistimit të subjekteve të studimit, rregjistrimi i të dhënave. |
| Staf teknik Nertila Kreshpaj | | | Ditë pune | 10.000 | *Funksioni:* Sekretare – FSH *Detyrat:* Mbajtja e dokumentacionit dhe asistenca teknike në dokumentimin e të dhënave dhe raportim. |
| Staf teknik Vjollca Zahaj | | | Ditë pune | - | *Funksioni:* Laborante – DI *Detyrat:* Personi i kontaktit, mbledhja e të dhënave kërkimore nëpërmjet intervistimit të subjekteve të studimit |
| Publikime/botime | | | | 60.000 | |
| Shpenzime administrative | | | | | |
| Të tjera (detajo) | | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË

Nr. ______ Prot.  Vlorë, më 13 /06 /2022

**Lënda:** Kërkesë për të Aplikuar për Mini-Projektet e financuara nga UV

**DREJTUESE E QËNDRËS KËRKIMORE SHKENCORE E SHËNDETIT PUBLIK**

**Dr. Fatjona KAMBERI**

E nderuar Znj. Drejtuese!

Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015, "PërArsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencorné Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqiperisë", Neni 93 "Veprimtaria kërkimore-shkencore", Neni 94 "Struktura e kërkimit shkencor" dhe Neni 95: "Kërkimi Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë" pika 1; Udhëzimit Nr. 29, datë 10-09-2018,si dhe skenarit 1,2 dhe 3 të Planit Strategjik të UV, Ju përcjell kërkesën për aplkimim në projektin me titull *"e-Shëndeti dhe vlerësimi i njohurive të studenteve dhe stafit akademik. Rekomandime për përditësim të kurrikulave infermierore"*. Ky projekt-propozim ka si qëllim kryesor vlerësimin e njohurive të studenteve dhe stafit akademik në lidhje me e-Shëndetin/shëndetin digjital.

Drtejtuese e projektit

**Dr. Fatjona Kamberi**

**Formati 1: Format Aplikimi i Projektit**

| INFORMACION I PËRGJITHSHËM I PROJEKT PROPOZIMIT | |
|---|---|
| Titulli i projektit | e-Shëndeti dhe vlerësimi i njohurive të studenteve dhe stafit akademik. Rekomandime për përditësim të kurrikulave infermierore<br>*e-Health and assessment of students' knowledge and academic staff's. Recommendations for updating nursing curricula* |
| Fusha ku aplikohet | Shëndetësia |
| Drtejtuesi i projektit | Dr. Fatjona Kamberi |
| Grupi i punës i Projektit | Brunilda Subashi<br>Krenar Malaj<br>Dalila Llanaj<br>Belinda Dauti<br>Samanta Likaj<br>Jonida Hoxha<br>Xhesika Dine |
| Qëllimi i studimit | Qëllimi Vlerësimi i njohurive të studenteve dhe stafit akademik në lidhje me e-Shëndet. |
| Objektivat kryesore | 1. Hartimi dhe validizimi në shqip i instrumentave që do të përdoren për mbledhjen e të dhënave.<br>2. Evidentimi i mungesës së njohurive në lidhje me e-Shëndetin dhe dizenjimi i ndërhyrjeve të fokusuara të bazuara në evidenca kryesisht për përditësimin e kurrikulave infermierore.<br>3. Të japi një panoramë të përgjithshme nëpërmjet rishikimit të literaturës për e-Shëndetin dhe rolin e tij në fuqizimin e pacientit në marrjen e vendimeve shëndetësore, në aksesin e shërbimit shëndetësor, në cilësinë e kujdesit të ofruar dhe në rezultatet shëndetësore të pacientit. |
| Kohëzgjatja e projektit (në muaj) | 12 muaj |
| Partnerët tëjashtëm (nëse ka) | - |

| | |
|---|---|
| Buxheti total i projektit | 100 000 Lekë |
| Kapaciteti i grupit të punës | Grupi i punës i ka të gjitha kapacitett për ta zhvilluar këtë projekt si nga na didaktikore dhe organizative. Në kuadër të kësaj të gjithë anëtarët e grupit të punës nga UV kanë një përvojë të gjërë në zhvillimin e kërkimeve operacionale në shëndetësi në bashkëpunim edhe me studentët. |
| Eksperienca të mëparshme të grupit të punës | – "Pandemia e COVID-19 dhe Niveli i Kulturës Shëndetësore Bazë dhe Digjitale (eHealth) në Popullatën e Përgjithshme – Dëshmi Bazë Praktike për të Dizenjuar Ndërhyrje Shëndetësore të Sakta, të Arritshme, dhe të Vepruеshme. Financuar nga UV. (2021).<br>– "Parandalimi dhe Menaxhimi i Sëmundjeve Kronike Diabet tipi 2 dhe Hipertension.Validizimi në shqip i modelit të kujdesit Patient Assessment of Chronic Illness Care-PACIC". Financuar nga UV. (2020).<br>– Cost (European Cooperation in Science and Technology) për thirrjen COST Action 19132 European Network to Advance Best practices & technoLogy on medication adherence. (2020). Kohëzgjatja 4 vjet.<br>– Erasmus+ KA226. (2020). Strengthening the basic knowledge and digital skills of the 21st century youth for life-long learning. Partnerships for Digital Education Readiness (KA226). Aplikuar.<br>– "Niveli i vetëmenaxhimit të diabetit tipi 2 te pacientët diabetik të Qytetit të Vlorës – implikime për kujdesin shëndetësor parësor". Mikro granti i nismës"Support to Operational Research on Health System and Services" for 2020-2021.Health for All Project (HAP), Swiss TPH. (2020). Shpallur fitues. |

**Tëdhënat e DrejtuesittëProjektit**

| | |
|---|---|
| Emër, mbiemër | Fatjona Kamberi |
| Institucioni | Fakulteti i Shëndetit, Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë |
| Postiqëmban | Drejtuese e Qendrës Kërkimore Shkencore e Shëndetit Publik |
| Gradashkencore | Doktore e Shkencave |
| Adresapostare | Skelë, Rruga Kosova, 9401 |
| Adresa e e-mail | fatjona.kamberi@univlora.edu.al<br>fatjonakamberi@gmail.com |

1. Identifikimi i problemit dhe rëndësia e zgjidhjes

Shëndeti digjital apo e-Shëndeti është një term që ka filluar të përdoret para vitit 1999, dhe që aktualisht duket se shërben si një "fjalë e përgjithshme" e përdorur për të karakterizuar jo vetëm "Mjekësinë në internet", por gjithashtu praktikisht gjithçka që lidhet me kompjuterët dhe mjekësinë. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) e përkufizon e-Shëndetin si: "... *përdorimi me kosto efektive dhe i sigurt i teknologjive të informacionit dhe komunikimit në mbështetje të shëndetit dhe fushave të lidhura me shëndetin duke përfshirë kujdesin shëndetësor, mbikëqyrjen shëndetësore dhe edukimin shëndetësor, njohuritë dhe kërkimet shkencore*". Kurse Komisioni Europian e përkufizon e-Shëndetin si: "... *përdorimi i teknologjive moderne të informacionit dhe komunikimit për të përmbushur nevojat e qytetarëve, pacientëve, profesionistëve të kujdesit shëndetësor, ofruesve të kujdesit shëndetësor, si dhe politikëbërësve*". Në varësi të mënyrës se si njerëzit zgjedhin ta përkufizojnë atë, Shëndeti digjital është një term ombrellë për të gjitha aplikacionet, teknologjitë dhe sistemet që lidhen me kujdesin shëndetësor që vijnë nga bashkimi i mjekësisë, gjenomikës dhe teknologjive që përbëjnë hapësirën digjitale, siç janë: Të dhënat elektronike të shëndetit; Të dhënat elektronike mjekësore.; Teleshëndeti dhe telemjekësia; Sistemet e Teknologjisë Informacionit (IT-së) shëndetësore; Të dhënat e IT të shëndetit të konsumatorit; Kujdesi shëndetësor virtual; dhe Shëndeti nëpërmjet celularit (mobile) (mShëndeti). Përfitimet e përdorimit të teleshëndet dhe telemjekësisë përfshijnë: Ulja e kostove të kujdesit shëndetësor; Rritja e aksesit të pacientit në kujdesin shëndetësor - veçanërisht në zonat e pambuluara me shërmbim shëndetësor të përshtatshëm; Përmirësimi i cilësisë dhe vazhdimësisë së kujdesit; Akses i përmirësuar tek kolegët e kujdesit shëndetësor nga ofruesit e kujdesit në distance; Rritja e saktësisë në ofrimin e kujdesit; Përdorimi i optimizuar i burimeve shëndetësore dixhitale; Shtrirja e përmirësuar e shërbimeve mjekësore të ofruara; Akses më i madh në edukimin e vazhdueshëm mjekësor; Koha e zvogëluar për diagnostikimin dhe trajtimin me konsulta të përshpejtuara; Përmirësim në mbledhjen e të dhënave dixhitale të shëndetit në zonat e thella; dhe Rritja e produktivitetit të stafit të kujdesit shëndetësor. Studimet kanë treguar se infermierët luajnë një rol qendror në shëndetin digjital. Pasi të jenë përfshirë në hartimin e planit të kujdesit, ata janë përgjegjës për fazën e regjistrimit të pacientëve (e cila përfshin trajnimin e pacientëve), për kontrollimin e përditshëm të të dhënave hyrëse, për triazhimin e ankesave të pacientëve dhe për fazën përfundimtare të intervistimit të pacientëve për përvojën e tyre me sistemin digjital të kujdesit shëndetësor. Por edhe pse komunikimi virtual në infermierinë midis institucioneve shëndetësore dhe profesionistëve shëndetësorë, dhe komunikimi virtual i infermierëve me pacientët po praktikohet gjithmonë e më shumë, në procesin e kompjuterizimit të sistemit të kujdesit shëndetësor, veçanërisht infermierët janë përballur me shumë vështirësi duke evidentuar dhe mungesa të njohurive adekuate me adresim edhe nevojën e trajnimeve dhe edukimeve në lidhje me përdorimin e e-Shëndetit. Shëndeti digjital ka potencialin për të përmirësuar parandalimin e sëmundjeve kronike ku infermierët luajnë rol kyç. Ky rol përqendrohet në efektivitetin e ndërhyrjeve parandaluese të e-Shëndetit dhe në rolin e shëndetit digjital në përmirësimin e promovimit të shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve. Gjithashtu ata luajnë rol thelbësor edhe në zbatimin e ndërhyrjeve të e-Shëndetit për parandalimin primar, sekondar dhe terciar të sëmundjeve kronike. Në Shqipëri, nuk ka të

dhëna shkencore në lidhje me njohuritë e studentëve infermierë si infermierë të ardhshëm në lidhje me e - Shëndetin. Nëpërmjet këtij studimi ne synojmë të adresojmë këtë mungesë me impakt në cilësinë e mësimdhënies, mësimnxënies dhe kujdesit shëndetësor të popullatës.

2. Lidhja e projekt-propozimit me prioritetet kombëtare strategjike dhe planinstrategjik të UV

*Prioriteti Strategjik 1:* Investimi në shëndetin e njerëzve gjatë gjithë ciklit të jetës:
*Objektivi strategjik 1.1:* Promovimi i stilit të shëndetshëm të jetës dhe mundësimi i zgjedhjeve të shëndetshme.
*Objektivi strategjik 1.2:* Fuqizimi i programeve parandaluese dhe promovuese të shëndetit publik (depistimi, shëndeti në shkollë, imunizimi).
*Objektivi strategjik 1.4:* Zvogëlimi i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së parandalueshme.
*Objektivi strategjik 1.5:* Akses në rritje i popullatës në programet parandaluese.
*Prioriteti strategjik 3:* Fuqizimi i sistemit shëndetësor, duke vendosur në qendër të sistemit njerëzit.
*Objektivi 3.2:* Gjenerimi i evidencave për të informuar dhe monitoruar politikat shëndetësore, nëpërmjet fuqizimit të sistemit të informacionit shëndetësor dhe regjistrave të sëmundjeve.

**Lidhja e projekt-propozimit me planin strategjik të UV**

| UV Plani Strategjik | Projekt propozimi |
|---|---|
| SKENARI I Partneritet dhe kooperim nderkombetar.<br><br>Linja strategjike Nr 1/ Partneritet dhe kooperim ndërkombëtar<br><br>Linja strategjike Nr 2/ Programe ndërkombëtare studimi dhe mobilitete afatgjata | ▪ Krijimi i bazës së të dhënave dhe vetë projekti krijojnë mundësi për rritje të bashkëpunimeve kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare për mobilitete të studentëve në mesin e iniciativave të ngjashme |
| SKENARI III<br><br>Linja Strategjike Nr 5/ Dimension Social | ▪ Rritje e vizibilitetit të UV në Komunitet dhe në mesin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor<br>▪ Dalja e Universitetit jashtë kornizave edukative dhe marrja e një roli aktiv edhe në çështje me ndikim social dhe zhvillimor<br>▪ Promovimi i UV si universitet smart dhe teknologjik<br>Krijmi i një kulture për shëndetin digjital që mungon duke e bërë edhe pjesë të CV profesionale të studentëve me impakt kur ata dalin në tregun e punës. |

3. **Qëllimi i projektit**

Vlerësimi i njohurive të studenteve dhe stafit akademik në lidhje me e-Shëndetin.

4. **Objektivat specifike të projektit**

1. Hartimi dhe validizimi në shqip i instrumentave që do të përdoren për mbledhjen e të dhënave.
2. Evidentimi i mungesës së njohurive në lidhje me eHealth dhe dizenjimi i ndërhyrjeve të fokusuara të bazuara në evidenca kryesisht për përditësimin e kurrikulave infermierore.
3. Të japi një panoramë të përgjithshme nëpërmjet rishikimit të literaturës për eHealth dhe rolin e tij në fuqizimin e pacientit në marrjen e vendimeve shëndetësore, në aksesin e shërbimit shëndetësor, në cilësinë e kujdesit të ofruar dhe në rezultatet shëndetësore të pacientit.

5. **Aktivitetet e projektit**

1. Zhvillimi i protokollit të studimit- rishikimi i literaturës.
2. Marrja e lejes etike për zhvillimin e studimit.
3. Hartimi, përkthimi dhe rakordimi në shqip i pyetësorëve.
4. Implementimi i studimit. Pretestimi-studimi pilot.
5. Mbledhja dhe krijimi i bazës së të dhënave.
6. Përpunimi statistikor dhe interpretimi i të dhënave
7. Publikimi i rezultateve të studimit (artikull).
8. Zhvillimit i leksioneve të hapura në nivel fakulteti për publikimin dhe promovimin e rezultateve të projektit. Tryeza të rrumbullakta me stakeholders lokal dhe komunitetin. Sesione informuese.Prezantimi i projektit në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.
9. Shkrimi i raportit teknik dhe financiar të projektit.

6. **Metodologjia për realizimin e objektivave të projektit**

Përshkrimi i detajuar i metodologjisë së kërkimit shkencor.
Studimi do të jetë i tipit transversal, sondazh i bazuar në internet duke përdorur platformën Google forms dhe adresën e emailit institucional si për studentët dhe stafin akademik. Popullatë e përgjithshme do të jenë studentët e Fakultetit të Shëndetit, (programet e studimit bachelor dhe master) dhe stafi akademik i po këtij fakulteti. Mbledhja e të dhënave do të kryhet nëpërmjet pyetësorit të vetëadministruar.Pyetësori do të hartohet dhe validizohet në kuadër të studimit nëpërmjet një studimi pilot. Studentët dhe stafi akdemik që do përbëjnë mostrën e pilotimit nuk do të përfshihen në analizën finale. Pjesëmarrëja në studim është vullnetare. Ata që do shprehin gadishmëri për të qënë pjesë e studimit do të kenë mundësi për tu përgjigjur vetëm njëherë. Pjesëmarrësit do të kenë mundësi që të japin miratimin e informuar nëpërmjet një opsioni të detyruar ku shprehin dakortësinë e tyre për pjesëmarrje në studim. Nëse nuk përzgjidhet ky opsion ata nuk mund të vazhdojnë plotësimin e pyetësorit.

Thirrja për pjesëmarrje në studim do të qëndroj e hapur dersia të arrihet numri i duhur i madhësisë së mostrës për sondazhet në internet. Validizimi i pyetësorit do të kryehet duke përdorur testet e përshtatshme statistikore.

Analizimi i të dhënave

Për të dhënat demografike dhe rezulatet e studimit do të përdoret statistika desktriptive e shprehur në mesatare, devijimin standart (SD) për variablat e vazhduar si dhe përqindjet për variablat kategorik. Për të testuar lidhjet statistikore midis variablave do të përdoren tabelat e kryqëzuara (MxN) dhe testi X2. Teste të ndryshme statistikore dhe analiza faktoriale do të përdoren për vlefshmërinë e të dhënave në fazën e validizimit të pyetësorit. Për të vlerësuar konsistencën e të dhënave do të përdoret testi Cronbach Alpha.

## 7. Rezultatet e pritshme të projektit

*Objektivi 1:* Krijimi dhe validizimi I një pyetesori për eHealth të përdorshëm nga kërkuesit shkencor, studentët dhe profesionistët.

*Rezultati 1:* Krijimi i një një modeli vlerësimi të eHealth të vlefshëm dhe të besueshëm për praktikën klinike në Shqipëri.

*Objektivi 2:* Vlerësimi i nivelit të njohurive dhe aftësive të studentëve infermier dhe stafit akademik për shëndetin digjital.

*Rezultati 1:* Nëpërmjet projekt propozimit do të evidentohen mungesat e njohurive e studentëve infemierë dhe stafit akademik me impakt në aftësitë e tyre profesionale dhe përdorimin e sistemit shëndetësor.

*Rezultati 2:* Rezultatet e studimit do të shërbejnë për të hartuar ndërhyrje edukative të fokusuara për studentët e infermierisë të por edhe për profesionistët e kujdesit shëndetësor.

*Objektivi 3:* Të japi një panoramë të përgjithshme nëpërmjet rishikimit të literaturës për gjendjen e e-Shëndetit, elementët përberës dhe roli i tij në shërbimin shëndetësor, akses dhe cilësi kujdesi.

*Rezultati 1:* Rekomandime (produkt i projekt propozimit) në politikat shëndetësore dhe stakeholdera lokal për hartimin e një udhëzuesi në lidhje me e-Shëndetin që mund të përdoret dhe nga profesionistët e kujdesit shëndetësor të cdo niveli.

*Rezultati 2:* Krijimi e një moduli edukimi shëndetësor për e-Shëndetin që mund të bëhet pjesë e kurrikulëve infermierore ose të ofrohet si kurs online ekstrakurrikular për përshtatje të planeve të kujdesit të pacientit duke marrë parasysh dhe e-Shëndetin dhe ndryshimet e diktuara nga teknologjia.

*Rezultati 3:* Krijimi i materialeve dhe videove edukuese për e-Shëndetin që mund tu shpërndahen studentëve infermier, stafit akademik dhe profesionistëve të kujdesit shëndetësor duke krijuar mundësinë e zhvillimit të studimeve zbatuese me impakt në forcimin e njohurive dhe aftësive në lidhje me e-Shëndeti si element i rëndësishëm aktual i praktikës klinike.

## 8. Përfitimet e Universitetit nga aplikimi në këtë projekt

- ☐ Rritja e standarteve të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në UV me përfitim për studentët dhe stafin akademik
- ☐ Dalja e Universitetit jashtë kornizave edukative dhe marrja e një roli aktiv edhe në çështje me ndikim social, teknologjik dhe zhvillimor

☐ Rritje e vizibilitetit të UV në mesin e profesionistëve të kujdesit shëndetësor, komunitetit, pacientët, komunitetin shkencor, stakehodersat lokal.
☐ Promovimi i UV për të thithur projekte dhe bashkëpunime ndërkomëtare në tematika të ngjashme
☐ Krijimi i një kulture në lidhje me shëndetin digjital që mungon duke e bërë edhe pjesë të CV profesionale të studentëve me impakt kur ata dalin në tregun e punës.

**9. Qëndrushmëria e rezultateve**

- Qëndrushmëria e të dhënave do të reflektohet te krijmi i një moduli edukativ për shëndetin digjital nga i cili do të përfitojnë të gjithë studentët actual dhe të ardhshëm të Fakultetit të Shëndetit (impakt afat-shkurtër, mesëm dhe afat-gjatë)
- Profesionistë të ardhshëm të shëndettit të fuqizuar dhe konkurues me tregun global të punës (impakt afat-gjatë)
- Përfitime me stafin akademik duke plotësuar boshëllëkun e nohurive të tyre në këtë drejtim me impakt në cilësinë e mësidhënies (impakt afat-shkurtër, mesëm dhe afat-gjatë)
- Trajnime edukative për shëndetin digjital profesionistëve të shëndetit (impakt afat-shkurtër, mesëm)
- Përmirësimi i shëndetit të popullatës (impakt afat-gjatë)

**10. Personeli që do të përfshihet në projekt**

| Grada shkencore | Emër mbiemër | Detyrat në projekt |
|---|---|---|
| Dr. | Fatjona Kamberi<br>Drejtuese e projektit | Shkrimi i projekt-propozimit, planifikimi i kërkimit shkencor, përgatitja e instrumentëve matës, përpunimi statistikor i të dhënave koordinimi dhe monitorimi i projektit, shkrimi i raportit final. |
| Msc. | Brunilda Subashi<br>Staf akademik | Rishikim i literaturës, përkthim dhe rakordim në shqip të pyetësorëve, kalimi i pyetësorëve ne google forms, mbledhje e të dhënave, përgatitje e publikimeve, rishikim dhe aprovim final të publikimeve. |
| Msc. | Krenar Malaj<br>Staf akademik | Rishikim i literaturës, mbledhje e të dhënave, rishikim dhe aprovim final të publikimeve. |
| Msc. | Belinda Dauti<br>Staf administrativ | Mbajtja e dokumentacionit dhe asistenca teknike në dokumentimin e të dhënave dhe raportim, aprovim final të publikimeve. |

| | | |
|---|---|---|
| Znj. | Dalila Llanaj<br>Laborante FSH | Mbajtja e dokumentacionit, Përkthim dhe rakordim në shqip të pyetësorëve, mbledhje e të dhënave, aprovim final të publikimeve. |
| Znj. | Samanta Likaj<br>Studente Master Shkencor | Përkthim dhe rakordim në shqip të pyetësorëve, mbledhje e të dhënave, aprovim final të publikimeve. |
| Znj. | Jonida Hoxha<br>Studente Master Shkencor | Përkthim dhe rakordim në shqip të pyetësorëve, mbledhje e të dhënave, aprovim final të publikimeve. |
| Znj. | Xhesika Dine<br>Studente Master Shkencor | Përkthim dhe rakordim në shqip të pyetësorëve, mbledhje e të dhënave, aprovim final të publikimeve. |

## 11. Plani i punës

| Aktivitetet | Viti 2022 | | | | | | | Viti 2023 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
| Zhvillimi i protokollit të studimit- rishikimi i literaturës. | X | X | X | | | | | | | | | | |
| Marrja e lejes etike për zhvillimin e studimit. | | X | X | | | | | | | | | | |
| Hartimi, përkthimi dhe rakordimi në shqip i pyetësorëve. | | | X | X | | | | | | | | | |
| Implementimi i studimit<br>Pretestimi-studimi pilot. | | | | X | X | X | | | | | | | |
| Implementimi i studimit-Mbledhja dhe krijimi i bazës së të dhënave. | | | | | | X | X | X | X | | | | |
| Përpunimi statistikor dhe interpretimi i të dhënave, hartimi i kurrikulës | | | | | | | | X | X | X | X | | |
| Publikimi i rezultateve të studimit (artikull). | | | | | | | | | X | X | X | | |
| Zhvillimit i leksioneve të hapura në nivel fakulteti, sesione informuese, publikime dhe promovimin e rezultateve të projektit.<br>Tryeza të rrumbullakta me stakeholders lokal dhe komunitetin.<br>Prezantime koferenca shkencore, kurse të akredituara | X | X | X | X | X | X | X | X | X | X | X | X | X |
| Shkrimi i raportit teknik dhe financiar të projektit. | | | | | | | | | | | | X | X |

## 12. Plani i punës sipas objektivave specifike

| Objektivi | Aktiviteti | Rezultati | Periudhakohore | Personipergjegjes |
|---|---|---|---|---|
| Hartimi dhe validizimi në shqip I pyetësorit që do të shërbej si instrument për mbledhjen e të dhënave. Krijimi I versionit shqip të pyetësorit për vlerësimin e njohurive për e Health të tyre të përdorshëm nga kërkuesit shkencor, studentët dhe profesionistët. Vlerësimi i nivelit të të njohurive të studentëve të Fakultetit të Shëndetit dhe stafit akdemik për eHealth Të japë një panoramë të përgjithshme nëpërmjet rishikimit të literaturës për gjendjen e eHealth, elementët përbërës dhe roli i tij në shërbimin shëndetësor, akses dhe cilësi kujdesi. | Studimi i literaturës, përcaktimi i popullatës, hartimi, përkthimi dhe rakordimi në shqip i pyetësorëve | Planifikimi i studimit | M 1-3 | Fatjona Kamberi |
| | Implementimi i studimit Pretestimi-studimi pilot | Përfshirja e individëvë në studim. | M 4-6 | |
| | Implementimi i studimitMbledhja dhe krijimi i bazës së të dhënave. | Evidentimi i njohurive dhe aftësive të studentëve infermier dhe stafit akademik në lidhje me eHealth. | M 6-9 | |
| | Përpunimi statistikor dhe interpretimi i të dhënave | Dizenjimi i ndërhyrje edukative të fokusuara për studentët infermierë për eHealth përfshirë harrtimin e një kurrikule të dedikuar që mund të jepet e integruar apo si kurs ektrakurrikular. | M 8-13 | |
| | Shkrimi i artikujve për publikim. | Botim artikulli | M 1-12 | Fatjona Kamberi |
| | Zhvillimit i leksioneve të hapura në nivel fakulteti, sesione informuese, publikime dhe promovimin e rezultateve të projektit. | Rekomandime (produkt i projekt propozimit) në politikat shëndetësore dhe stakeholdera lokal për hartimin e një udhëzuesi në lidhje me e Health që mund të përdoret dhe nga profesionistët e kujdesit shëndetësor të cdo niveli. | M 6-12 | |
| | Tryeza të rrumbullakta me stakeholders lokal dhe komunitetin. | Krijimi e një moduli edukimi shëndetësor për e Health që mund të bëhet pjesë e kurrikulëve infermierore ose të ofrohet si kurs online ekstrakurrikular për përshtatje të planeve të kujdesit të pacientit duke marrë parasysh dhe eHealth dhe ndryshimet e diktuara | M 6-12 | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | nga teknologjia. | | |
| | Prezantime koferenca shkencore, kurse të akredituara | Krijimi i materialeve dhe videove edukuese për e Health që mund tu shpërndahen studentëve infermier, stafit akademik dhe profesionistëve të kujdesit shëndetësor duke krijuar mundësinë e zhvillimit të studimeve zbatuese me impakt në forcimin e njohurive dhe aftësive në lidhje me eHealth si element i rëndësishëm aktual i praktikës klinike. | M 6-12 | |
| | Shkrimi i raportit teknik/shkencor dhe i raportit financiar | Dorëzimi i raportit shkencor | M 11-12 | |

Gjatë dhe pas përfundimit të projektit në emër të grupit të punës marr përsipër ti siguroj Qendrës Kërkimore Shkencore dhe Dekanatit të Shëndetit të gjithë dokumentacionin dhe produktet e projektit si dhe një kopje të plotë të raportit përfundimtar të projektit.

Faleminderit për bashkëpunimin,

Në emër të grupit të punës

**Dr. Fatjona Kamberi**

**Formati2: Formati i propozimit financiar**

1. Titulli i projektit: "e-Shëndeti dhe vlerësimi i njohurive të studenteve dhe stafit akademik. Rekomandime për përditësim të kurrikulave infermierore"
2. Drejtuesi i projektit; **Dr. Fatjona Kamberi**

| | Zëri në buxhet | Njësia | Sasia | Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë | Totali Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë | Përshkrimi i detajuar |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Tipi | Pagat e personelit (e detajuar për drejtuesin dhe stafin) | | | | | |
| 1 | Drejtuesi i projektit - Dr. Fatjona Kamberi | ditë pune | | | 20 000 | Pedagoge, QKSH per Shendetin Publik- *Funksioni:* Koordinimi dhe menaxhimi I projektit, shkrimi i projekt-propozimit, planifikimi i kërkimit shkencor, përgatitja e instrumentëve matës, përpunimi statistikor i të dhënave koordinimi dhe monitorimi i projektit, shkrimi i raportit final. |
| 3 | Bruna.Subashi - Msc. | ditë pune | | | 20 000 | Pedagoge, QKSH per Shendetin Publik- *Funksioni:* Rishikim i literaturës, përkthim dhe rakordim në shqip të pyetësorëve, kalimi i pyetësorëve ne google forms, mbledhje e të dhënave, përgatitje e publikimeve, rishikim dhe aprovim final të publikimeve. |
| 3 | Krenar Malaj - Msc. | ditë pune | | | 20 000 | Pedagog, QKSH per Shendetin Publik- *Funksioni:* Rishikim i literaturës, mbledhje e të dhënave, rishikim dhe aprovim final të publikimeve. |
| 4 | Belinda Dautaj - Msc | dite pune | | | 20 000 | Sekretare - Fakulteti i Shëndetit *Funksioni:* mbajtja e dokumentacionit dhe asistenca teknike në dokumentimin e të dhënave dhe raportim. |
| 5 | Dalila Llanaj | dite pune | | | 20 000 | Laborante - Fakulteti i Shëndetit *Funksioni:* Përkthim dhe rakordim në shqip të pyetësorëve, mbledhje e të dhënave, aprovim final të publikimeve. |
| | Totali e Pagave | | | | **100 000 Mijë Lekë** | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË

**Formati 1: Format Aplikimi i Projektit**

Nr. ....... Prot. Vlorë, më 15/06/2022

**Lënda:** Kërkesë për të Aplikuar për Mini-Projekte të financuara nga UV

I/E nderuar Znj. Dekane, Prof .Asoc. Aurela Saliaj

Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqiperisë", Neni 93 "Veprimtaria kërkimore-shkencore", Neni 94 "Struktura e kërkimit shkencor" dhe Neni 95: "Kërkimi Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë" pika 1; Udhëzimit Nr. 29, datë 10-09-2018, si dhe skenarit 1,2 dhe 3 të Planit Strategjik të UV, Ju përcjell kërkesën për aplkimim në projektin me titull "Crregullimet e gjumit, identifikimi i faktorëve që ndikojnë në crregullim dhe mënyrat e parandalimit". Ky projekt-propozim ka si qëllim kryesor: Vlerësimi i crregullimeve të gjumit dhe identifikimi i faktorëve që ndikojnë në crregullim në popullatën e përgjithshme si elementë thelbësor për të hartuar ndërhyrje shëndetësore efikase në funksion të parandalimit të crregullimeve dhe përmirësimit të shëndetit.

| INFORMACION I PËRGJITHSHËM I PROJEKT PROPOZIMIT | |
|---|---|
| Titulli i projektit | Crregullimet e gjumit, identifikimi i faktorëve që ndikojnë në crregullim dhe mënyrat e parandalimit. |
| Fusha ku aplikohet | Shëndetësia |
| Drtejtuesi i projektit | **Dr. Glodiana Sinanaj** |
| Grupi i punës i Projektit | **Prof. Dr.Yllka Stramarko**<br>**Dr. Petraq Mustaqe**<br>**Msc. Jerina Celaj**<br>**Msc. Silda Caushaj**<br>**Msc. Elida Trushaj**<br>**Msc. Dhurata Shena**<br>**Znj. Blenora Kapaj** |
| Qëllimi i studimit | Vlerësimi i crregullimeve të gjumit dhe identifikimi i faktorëve që ndikojnë në crregullim në popullatën e përgjithshme si elementë thelbësor për të hartuar ndërhyrje shëndetësore efikase në funksion të parandalimit të crregullimeve dhe përmirësimit të shëndetit. |
| Objektivat kryesore | 1. Validizimi në shqip i instrumentit Sleep Quality Assessment (PSQI) Vlerësimi i cilësisë së gjumit (PSQI) i cili është një instrument efektiv që përdoret për të matur cilësinë dhe modelet e gjumit tek të rriturit, për të krijuar versionin në shqip të tij të përdorshëm nga kërkuesit shkencor, studentët dhe profesionistët.<br>2. Vlerësimi i crregullimeve të gjumit dhe identifikimi i faktorëve që ndikojnë në crregullim në popullatën e përgjithshme.<br>3. Të paraqesë një tablo të përgjithshme nëpërmjet rishikimit të literaturës për crregullimet e gjumit, identifikimin e faktorëve që ndikojnë në crregullim dhe mënyrat e parandalimit për të patur impakt në sjelljet shëndetësore të popullatës. |

| | |
|---|---|
| Kohëzgjatja e projektit (në muaj) | 12 muaj |
| Partnerët të jashtëm (nëse ka) | |
| Buxheti total i projektit | 100,000 |
| Kapaciteti i grupit të punës | ***Glodiana Sinanaj***<br>**(2020-2021)** "Parandalimi dhe Menaxhimi i Sëmundjeve Kronike Diabet tipi 2 dhe Hipertension.Validizimi në shqip i modelit të kujdesit Patient Assessment of Chronic Illness Care PACIC" –financuar nga UV.(2020)<br>Bashkautore në shkrimin e projektit<br>**(2021-2022)** Pandemia e COVID-19 dhe Niveli i Kulturës Shëndetësore Bazë dhe Digjitale (eHealth) në Popullatën e Përgjithshme – Dëshmi Bazë Praktike për të Dizenjuar Ndërhyrje Shëndetësore të Sakta, të Arritshme, dhe të Veprueshme- financuar nga UV. (2021)<br>***Jerina Celaj***<br>**(2020-2021)**Niveli i vetë-kujdesit te pacientët me diabet mellitus tipi II-implikime për kujdesin shëndetësor parësor" me mbështetjen e "Shëndet për të Gjithë"-një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i zbatuar nga Instituti Zviceran i Shëndetit Publik dhe Mjekësisë Tropikale (STPH). Drejtuese e Projektit<br>**(2020-2021)** Njohuritë e stafit shëndetësor të qytetit të Vlorës dhe Fierit, lidhur me efektet e vitaminës D në shendet. Drejtuese e projektit te financuar nga UV.<br>**(2020-2021)** "Parandalimi dhe Menaxhimi i Sëmundjeve Kronike Diabet tipi 2 dhe Hipertension.Validizimi në shqip i modelit të kujdesit Patient Assessment of Chronic Illness Care PACIC" –financuar nga UV.(2020)<br>Bashkautore në shkrimin e projektit |
| Eksperienca të mëparshme të grupit të punës | ***Glodiana Sinanaj***<br>**(2021)** Impact of COVID-19 pandemic on mental health, risk perception and coping strategies among health care workers in Albania - evidence that needs attention. Clinical Epidemiology |

| | |
|---|---|
| | and Global Health, Volume 12, 2021, 100824, ISSN 2213-3984.<br>**(2020)** Melanoma, shkaqet, faktoret e rrezikut, parandalimi i saj, masat mbrojtese kunder kancerit te lekures. Reviste shkencore zyrtare e publikuar nga Fakulteti I Shkencave Mjekesore Teknike Universiteti I Mjekesise, Tirane. ISSN 2616-9290 Suplement 1/2020<br>**(2019)** Protective measures to be taken by nursing staff to hiv/aids patients and students knowledge of them. Intensive and Critical Care Nursing & 4th Euro Nursing and Healthcare Congress. Journal of Nursing Research and Practice. October 14-15, 2019/ Rome, Italy Volume 03 ISSN: 2632-251X<br>**(2018)** The internet, the main source of hiv/ aids information on students. International Journal of Innovative Science and Research Technology. ISSN NO 2456-2165. Volume 3, Issue 1, p.672- 676. January – 2018.http://ijisrt.com/the-internet-the-main-source-of-hiv-aids-information-on-students<br>**(2018)** The role of nurses in the treatment and care of hiv/aids patients - based on the dimensions of health care. International Journal for Innovation Education and Research. Vol 6 No 1 (2018):p.199-212, 31 jan 2018. ONLINE ISSN: 2411-2933DOI prefix: 10.31686IMPACT FACTOR: 2018 - 5.125 (link)http://ijier.net/ijier/article/view/935<br>**(2018)** Woman with osteoporosis present their quality of life: three cases from Vlore, Albania. Archives of Community Medicine and Public Health 4(2): 069-072. DOI: http://dx.doi.org/10.17352/2455-5479.000040<br>**(2017)** Physical activity recommended for osteoporosis prevention. Durresamin Journal Australia, November ,Vol 3 Issue 3, Year 2017 ISSN: 2204-9827. https://durreesaminjournal.wordpress.com/nov2017/ Pages: 111-119. ISSN: 2156-6992 :: 4(1):111–119 (2014) DOI: 10.15244/pjocs/70895<br>***Jerina Celaj***<br>**(2021)** Të jetosh me diabet dhe sëmundje celiake - Një studim rasti. Buletini Shkencor UV, ISSN 2310-6719 |

| | |
|---|---|
| | UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË Numri 4, Volumi 2.<br>**(2021)** Impact of COVID-19 pandemic on mental health, risk perception and coping strategies among health care workers in Albania - evidence that needs attention.<br>https://doi.org/10.1016/j.cegh.2021.100824<br>**(2021)** Myo-inositol vs Metformin in Women with Polycystic Ovary Syndrome and Insulin Resistance. Buletini Shkencor UV, ISSN 2310-6719 UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË Numri 4, Volumi 2.<br>**(2020)** A retrospective study for Colorectal Cancer in Vlore, Albania-suggestions for further implications.Arch Cancer Sci Ther. 2020; 4: 003-006. DOI: 10.29328/journal.acst.1001013 ORCiD: orcid.org/0000-0003-4793-938<br>**(2020)** Eating Patterns and Adherence to the Mediterranean Diet: A Cross-Sectional Study in Albania. European Scientific Journal July 2020 edition Vol.16, No.21 ISSN: 1857-7881 (Print) e - ISSN 1857-7431<br>**(2020)** Importance of nurse's work in cancer prevention. Journal of Cancer Epidemiology & Prevention 2020, Volume 05.<br>**(2020)** Effect of Covid-19 pandemic on mental health among Albanian people residing in the country and abroad – Implications for mental care.<br>https://doi.org/10.1016/j.apnu.2020.08.003<br>Predictors of nurses' intention to accept COVID-19 vaccination: A cross-sectional study in five European countries https://doi.org/10.1111/jocn.15980<br>**(2018)** Evidence of gastric cancer cases, year survival rate and frequent symptoms – A retrospective study at Vlora regional hospital, Albania. Cancer Reports and Reviews Cancer Rep Rev, 2018 doi: 10.15761/CRR.1000172 Volume 2(6): 1-4 ISSN: 2513-9290 |

**Të dhënat e Drejtuesit të Projektit**

| | |
|---|---|
| Emër, mbiemër | Dr. Glodiana Sinanaj |
| Institucioni | Fakulteti i Shëndetit, Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë |
| Posti që mban | Anëtare e Qendrës Kërkimore Shkencore e Shëndetit Publik |
| Grada shkencore | Doktore e Shkencave |
| Adresa postare | Skelë, Rruga Kosova, 9401 |
| Adresa e e-mail | glodiana.sinanaj@univlora.edu.al<br>glodisinanaj78@hotmail.com |

1. Identifikimi i problemit dhe rëndësia e zgjidhjes

Çrregullimet e gjumit (ose çrregullimet e gjumit-zgjimit) përfshijnë probleme me cilësinë, kohën dhe sasinë e gjumit, të cilat rezultojnë në shqetësime gjatë ditës dhe dëmtim të funksionimit. Ekzistojnë disa lloje të ndryshme të çrregullimeve të gjumit-zgjimit, nga të cilat pagjumësia është më e zakonshme. Çrregullime të tjera gjumë-zgjimi përfshijnë apnea obstruktive të gjumit, parasomnitë, narkolepsinë dhe sindromën e këmbëve të shqetësuara. Gjumi i pamjaftueshëm shoqërohet me një sërë rezultatesh negative shëndetësore dhe sociale, duke përfshirë një performancë të pafavorshme në shkollë dhe në tregun e punës. Zvogëlimi i kohëzgjatjes së gjumit është lidhur me 7 nga 15 shkaqet kryesore të vdekjes në botë, duke përfshirë sëmundjet kardiovaskulare, neoplazmën malinje, sëmundjet cerebrovaskulare, aksidentet, diabetin, septiceminë dhe hipertensionin. Studimet kanë treguar se "Të bësh një gjumë të mirë ndihmon në rritjen e sistemit imunitar dhe duhet të jetë një pjesë e rëndësishme e rutinës së përditshme, së bashku me ushqimin e shëndetshëm dhe qëndrimin fizikisht aktiv".Kërkohen informacione të ndryshme për të vlerësuar problemet e gjumit. Pas një historie të detajuar mjekësore, historisë së mjekimit dhe ekzaminimit fizik; disa nga investigimet e duhura për të diagnostikuar çrregullimet e gjumit janë si më poshtë: *Ditari i gjumit:* Ditari i gjumit, ose regjistri i gjumit, është një regjistrim subjektiv në letër i gjumit dhe zgjimit për një periudhë prej javësh deri në një muaj. *Studimet e gjumit:* Masat objektive të gjumit mund të merren nga studimet e gjumit si elektroencefalografia (EEG) ose polisomnografia (PSG). PSG konsiderohet kryesisht si standardi i artë për diagnozën e OSA dhe çrregullimeve të tjera të gjumit. *Studime laboratorike:* Disa nga studimet laboratorike të përshtatshme për ata me çrregullime të gjumit përfshijnë:Hemoglobina dhe hematokriti,Gazrat e gjakut arterial (ABG), Testet e funksionit të tiroides. *Oksimetria gjatë natës:* Kjo përfshin

përdorimin e një sonde që mbahet në gisht ose në llapë të veshit, e cila mat vazhdimisht nivelet e oksigjenit dhe rrahjet e zemrës. *Testimi i shumëfishtë i vonesës së gjumit (MSLT)*: Ky është një test objektiv që përcakton shkallën e përgjumjes. Në ditën pas një studimi të PSG gjatë natës, pacientit i kërkohet të marrë katër ose pesë dremitje për një periudhë prej 8-10 orësh. *Indekset dhe sistemet e vlerësimit:* Indeksi i cilësisë së gjumit të Pittsburgh (PSQI) është një instrument efektiv që përdoret për të matur cilësinë dhe modelet e gjumit tek të rriturit. Ai dallon cilësinë e gjumit "të dobët" nga "i mirë" duke matur shtatë zona (konponentë): cilësia subjektive e gjumit, vonesa e gjumit, kohëzgjatjen e gjumit, efikasitetin e zakonshëm të gjumit, shqetësimet e gjumit, përdorimin e medikamenteve të gjumit dhe mosfunksionimin e ditës gjatë muajit të fundit. Barra e Shëndetit Publik të mungesës kronike të gjumit dhe çrregullimeve të gjumit, së bashku me ndërgjegjësimin e ulët të popullatës së përgjithshme, profesionistëve të kujdesit shëndetësor dhe politikëbërësve kërkon një strategji të mirëkoordinuar për të përmirësuar kujdesin shëndetësor të lidhur me gjumin. Rritja e ndërgjegjësimit, përmirësimi i diagnostikimit dhe trajtimit të çrregullimeve të gjumit kërkon një përpjekje të shumëanshme që përfshin tre komponentë kyç: edukimin publik, trajnimin për profesionistët shëndetësorë, mbikëqyrjen dhe monitorimin.

2. Lidhja e projekt-propozimit me prioritetet kombëtare strategjike dhe planin strategjik të UV

Prioriteti Strategjik 1: Investimi në shëndetin e njerëzve gjatë gjithë ciklit të jetës:

Objektivi strategjik 1.1: Promovimi i stilit të shëndetshëm të jetës dhe mundësimi i zgjedhjeve të shëndetshme.

Objektivi strategjik 1.2: Fuqizimi i programeve parandaluese dhe promovuese të shëndetit publik (depistimi, shëndeti në shkollë, imunizimi).

Objektivi strategjik 1.4: Zvogëlimi i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së parandalueshme.

Objektivi strategjik 1.5:Akses në rritje i popullatës në programet parandaluese.

Prioriteti strategjik 3: Fuqizimi i sistemit shëndetësor, duke vendosur në qendër të sistemit njerëzit.

Objektivi 3.2: Gjenerimi i evidencave për të informuar dhe monitoruar politikat shëndetësore, nëpërmjet fuqizimit të sistemit të informacionit shëndetësor dhe regjistrave të sëmundjeve.

3. Qëllimi i projektit

Vlerësimi i crregullimeve të gjumit dhe identifikimi i faktorëve që ndikojnë në crregullim në popullatën e përgjithshme si elementë thelbësor për të hartuar ndërhyrje shëndetësore efikase në funksion të parandalimit të crregullimeve dhe përmirësimit të shëndetit.

4. Objektivat specifike të projektit

1. Validizimi në shqip i instrumentit Sleep Quality Assessment (PSQI) Vlerësimi i cilësisë së gjumit (PSQI) i cili është një instrument efektiv që përdoret për të matur cilësinë dhe modelet e gjumit tek të rriturit, për të krijuar versionin në shqip të tij të përdorshëm nga kërkuesit shkencor, studentët dhe profesionistët.

2. Vlerësimi i crregullimeve të gjumit dhe identifikimi i faktorëve që ndikojnë në crregullim në popullatën e përgjithshme.

3. Të paraqesë një tablo të përgjithshme nëpërmjet rishikimit të literaturës për crregullimet e gjumit, identifikimin e faktorëve që ndikojnë në crregullim dhe mënyrat e parandalimit për të patur impakt në sjelljet shëndetësore të popullatës.

5. Aktivitetet e projektit

1. Zhvillimi i protokollit të studimit- rishikimi i literaturës.
2. Marrja e lejes etike për zhvillimin e studimit.
3. Përkthimi dhe rakordimi në shqip i pyetësorëve.
4. Implementimi i studimit. Pretestimi-studimi pilot.
5. Mbledhja dhe krijimi i bazës së të dhënave.
6. Përpunimi statistikor dhe interpretimi i të dhënave
7. Publikimi i rezultateve të studimit (artikull).
8. Aktivitete promocionale të bazuara në evidenca me fokus komunitetin.
9. Shkrimi i raportit teknik dhe financiar të projektit.

6. Metodologjia për realizimin e objektivave të projektit

Studimi do të jetë i tipit kros-seksional. Popullatë e përgjithshme mosha ≥40 vjec do të jetë popullata e studimit. Do të synohet që popullata target do të jetë ajo lokale-e qytetit të Vlorës për të dhënë një panoramë të plotë në lidhje me crregullimet e gjumit të popullatës dhe identifikimin e faktorëve në kontekstin lokal. Mbledhja e të dhënave do të kryhet nëpërmjet përdorimit të pyetësorit

(PSQI) (Sleep Quality Assessment Instrument) Instrumenti për Vlerësimin e Cilësisë së Gjumit. Mbledhja e të dhënave do të bëhet e rastësishme në popullatën në rrugë. Për të garantuar konsistencën e të dhënave pyetësorët do të përkthehen, rakordohen në gjuhën shqipe dhe do të kryhet validizimi i tyre nëpërmjet një studimi pilot. Pyetësori për vlerësimin e cilësisë së gjumit përbëhet nga 9 pyetje me shkallë vlerësimi Linkert nga 0 (shumë mirë) në 3 (shumë keq). Pyetësori për vlerësimin e cilësisë së gjumit përbëhet nga 9 pyetje, 4 pyetjet e para janë pyetje të hapura, pyetja e 5 ka dhjetë nënpyetje nga shkronja A në J ku në secilën prej tyre duhet zgjedhur 1 alternativë e mundshme me detyrim, 4 pyetjet e fundit kanë alternativa të mundshme me detyrimin për të përzgjedhur vetëm 1 alternativë. Administrimi i pyetësorit do të kryhet në terren nëpërmjet angazhimit të studentëve të Masterit Shkencor të Fakultetit të Shëndetit. Pjesëmarrësit që do shprehin gadishmëri për të qënë pjesë e studimit do të kenë mundësi për tu përgjigjur vetëm njëherë. Do synohet të lihet mostra 375 për studimet kros-seksionale.

Analizimi i të dhënave

Për të dhënat demografike dhe rezulatet e studimit do të përdoret statistika desktriptive e shprehur në mesatare, devijimin standart (SD) për variablat e vazhduar si dhe përqindjet për variablat kategorik. Për të testuar lidhjet statistikore midis variablave do të përdoren tabelat e kryqëzuara (MxN) dhe testi X2. Teste të ndryshme statistikore dhe analiza faktoriale do të përdoren për vlefshmërinë e të dhënave në fazën e validizimit të pyetësorit.

7. Rezultatet e pritshme të projektit

**Objektivi 1**: Validizimi në shqip i instrumentit (PSQI) (Sleep Quality Assessment Instrument) për të krijuar versionin në shqip të tij të përdorshëm nga kërkuesit shkencor, studentët dhe profesionistët.

**Rezultati 1**: Krijimi i një instrumenti në gjuhën shqipe që mund të përdoret në praktikë për vlerësimin e gjumit.

**Objektivi 2**: Vlerësimi i crregullimeve të gjumit dhe identifikimi i faktorëve që ndikojnë në crregullim në popullatën e përgjithshme

**Rezultati 1**: Nëpërmjet projekt propozimit do të evidentohen faktorët influencues në crregullimet e gjumit dhe do të përcaktohen mënyrat e parandalimit me impakt në ndryshim të sjelljeve shëndetësore.

**Rezultati 2**: Rezultatet e projektit do të shërbejnë për të hartuar ndërhyrje edukative promocionale shëndetësore të fokusuara në evidenca.

**Objektivi 3**: Të paraqesë një tablë të përgjithshme nëpërmjet rishikimit të literaturës për çrregullimet e gjumit, identifikimin e faktorëve që ndikojnë në çrregullim dhe mënyrat e parandalimit për të patur impakt në gjendjet shëndetësore të popullatës.

**Rezultati 1**: Rekomandime (produkt i projekt propozimit) në politikat shëndetësore dhe lokale për hartimin e një plani veprimi në lidhje me përmirësimin e kujdesit shëndetësor të popullatës.

8. Përfitimiet e Universitetit nga aplikimi në këtë projekt

